| 14 | 22.6.2023 | Nga ëebsite juaj kam mesuar qe mbeshtesni subjekte te vogla, perfshire ato ne fushen e artizanatit, per tu forcuar dhe siguruar qendrueshmeri ne te ardhmen. Do ta vleresoja nese mund te me jepni nje informacion me te | 4.7.2023 | Mbeshtetja permes " Fondit te artizaneve" konsistonte ne mbeshtetjen financiare te artizaneve, per t'ju dhene atyre mundesine e formalizimit te aktiviteteit, zgjerimit dhe permiresimit te games se produkteve artizanale, trajnimin e | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | detajuar mbi mundesite qe ju ofroni per llojin e biznesit qe une perfaqesoj. Nese ka ndonje projekt aktual apo planifikoni te zbatoni ne te ardhmen ne te cilin mund te aplikoj, ju lutem me informoni.<br>Si nje biznes i ri, vleresoj cdo mbeshtetje per ngritjen e kapaciteteve apo dhe per mbeshtetjen e ideve dhe projekteve qe kemi. | | te rinjve te apasionuar per te siguruar vazhdimesine e artizanatit, permiresimin e kushteve teknike te prodhimit te artikujve etj.<br>Ministria e Kultures, ne bashkepunim me Qendren Kombetare te Veprimtarive Tradicionale, eshte duke krijuar nje database te artizaneve ne gjithe vendin, i cili do te kete ne permbajtje edhe nje pershkrim te shkurter te nevojave qe ata kane. Nese jeni i interesuar, mund t'ju dergojme formularin dhe ta plotesoni sipas te dhenave dhe te beheni pjese e data base qe po krijohet.<br>Gjithashtu, mbeshtetur edhe ne kete data base, Ministria planifikon te hape Thirrjen per vitin 2024 " Fondi i artizaneve", pjese e te | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | cilit mund te beheni edhe ju. | | |
| 15 | 20.6.2023 | 1. Cilat janë investimet e realizuara në Kalanë e Peqinit gjatë periudhës janar 2020-janar<br>2023?<br>2. Sa është shuma e parave të investuara në këtë kala dhe në cila zona të saj janë kryer ndërhyrjet?<br>3. Sa është shuma vjetore që shpenzohet për mirëmbajtjen e kalasë së Peqinit?<br>4. Cilat janë investimet e realizuara në Kalanë e Bashtovës gjatë periudhës janar 2020-janar<br>2023?<br>5. Sa është fondi që ka shkuar për realizimin e ndërhyrjeve në kalanë e Bashtovës?<br>6. Sa është shuma vjetore që shpenzohet për mirëmbajtjen e kalasë së Bashtovës? | 27.6.2023 | 1.Nga buxheti I shtetit te IKTK gjate periudhes se kerkuar nuk ka investime nen kete objekt.<br>2.Nuk ka pergjigje.<br>3.Per mirembajtejen e Kalase se Peqinit, bucheti per mirembajtjen e saj (si dhe objekteve te tjera monumente kulture) I kalohet DRTK Korce.<br>4. Nga buxheti I shtetit te IKTK gjate periudhes s ekerkuar nuk ka investime ne kee object.<br>5. Nuk ka pergjigje.<br>6. Per mirembajtjen e kalase se Peqinit buxheti per mirembajtjen e saj I kalohet DRTK Korce. | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | 27.6.2023 | Kërkoj të më vihen në dispozicion relacionet përfundimtare të VKM-ve të mëposhtme, të miratuara me propozim të Ministrit të Kulturës, si në vijim: “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.228, datë 13.4.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për financimin e Festivalit Folklorik Kombëtar Gjirokastër, 24 qershor – 2 Korrik 2023”” | 7.7.2023 | Dokumentacioni është vënë në dispozicion. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka |
| 17 | 20.6.2023 | Kerkese per informacion per te kuptuar me teper ne lidhje me vlerësimin e instrumentave financiarë të cilat mbështesin industritë kulturore dhe kreative. | - | - | Ne proces Brenda institucionit. | - |

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**

| Nr. Rendor [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 12.7.2023 | Cilat janë masat që janë ndërmarrë nga Minisria e Kulturës lidhur me disa nga rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës "Mbrojtja dhe Administrimi i Monumenteve të Kulturës", publikuar në shtator 2022 nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. | 6.9.2023 | 1. MK, në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të hartojë planin e emergjencave civile, për të zvogëluar pasojat negative të diktuara në raste fatkeqësish natyrore dhe luftrash duke garantuar mbrojtjen e monumenteve të kulturës.<br><br>Me bashkëpropozim të Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme është hartuar dhe miratuar | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | VKM nr. 420, datë 15.6.2022 “Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura”.<br>Për sa i përket Planit të Emergjencave Civile ju bëjmë me dije se ky Plan është duke u përgatitur nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet e varësisë.<br><br>2. MK, për kontrollin e zonave të mbrojtura si dhe dhe mbrojtjen nga çdo ndërhyrje pa leje brenda tyre, në kuadrin e planeve të veta sektoriale, sipas fushës së përgjegjësisë dhe në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe ministrinë përgjegjëse për zhvillimin e territorit, të propozojë, hartojë dhe miratojë planet kombëtare të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | peizazhit, sidomos për ato që përfshihen në UNESCO, si dhe të marrë masat për rekrutimin e stafit teknik të peizazhit, nevojë dhe domosdoshmëri për hartimin e këtyre planeve dhe menaxhimin e zinxhirit të proceseve për administrimin e monumenteve të kulturës.<br><br>Duke qenë se ky rekomandim kërkon ndryshime strukturore të Ministrisë së Kulturës, në kuadër të hartimit të planeve të peizazhit, MK ka filluar punën për përmbushjen e këtij rekomandimi.<br><br>3. MK të miratojë aktet nënligjore për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim të pasurive | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kulturore dhe të hartojë kuadrin e plotë rregullator për dhënien në përdorim të tyre me qëllim rijetëzimin në të gjitha format e përdorimit të tyre.<br><br>Ministria e Kulturës ka propozuar projektaktin e miratuar me vendimin nr. 560, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim indirekt të pasurive kulturore personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë"<br><br>4. MK të hartojë dhe të dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave 31 aktet nënligjore të parashikuara në planin analitik për periudhën 2019 -2021, paraqitur në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij raporti auditimi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Lidhur me hartimin dhe miratimin e 31 akteve nënligjore, sqarojmë se për shkak të teknikaliteteve përmbajtësore të akteve nënligjore dhe për shkak të numrit të lartë të tyre, Ministria e Kulturës është duke punuar intensivisht për hartimin dhe miratimin e tyre. Aktualisht sqarojmë se janë miratuar disa VKM si:<br><br>1. Vendimin nr. 560, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e procedurave publike për dhënien në administrim indirekt të pasurive kulturore personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë"<br>2. Vendimin nr. 465, datë 26.7.2023 "Për përcaktimin e listës së pajisjeve dhe tarifave përshpërblimin e arsyeshëm për riprodhimin e veprave | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të autoritpër përdorim privat ose përdorim tjetër personal”<br>3.Vendim nr. 464, datë 26.7.2023 “Për funksionimin, organizimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë të Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim”.<br><br>Dhe janë në fazë dakordësie dhe miratimi 10 (dhjetë) udhëzime.<br><br>5. MK, në cilësinë e institucionit epror përgjegjës për mirëmenaxhimin e monumenteve të kulturës, të ngrejë një grup pune ku të përfshihen të gjithë institucionet e sistemit kombëtar për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore, me bashkëpunimin dhe mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe institucioneve të tjera, me qëllim hartimin e një dokumenti strategjik dhe një plani veprimi konkret për inventarizimin dhe vlerësimin e aseteve “trashëgimi kulturore” në vendin tonë.<br><br>Është ngritur grupi i punës me urdhrin nr.239 dt. 11.04.2023 “Për ngritjen e strukturës se posaçme me qellim identifikimin e listës/pronave qe do ti nënshtrohen procesit te inventarizimit, plotësimit, përditësimit dhe ndjekjen e procesit deri ne regjistrimin e pronave ne regjistrin kadastral publik te pasurive te paluajtshme dhe pajisjen me certifikate për çdo pasuri", I ndryshuar me urdhrin nr.483 dt., 04/08/2023 ka hartuar listën totale dhe listën me 30 prioritete. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 6. MK, në bashkëpunim me IKTK dhe DRTK–të, të ngrejë një grup pune për të evidentuar të gjitha problematikat lidhur me pronësinë e monumenteve të kulturës duke evidentuar hapat që duhen ndjekur për të zgjidhur këto problematika, në përfitim të procesit të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve të trashëgimisë kulturore materiale të paluajtshme.<br><br>Grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.239 dt. 11.04.2023 “Për ngritjen e strukturës se posaçme me qellim identifikimin e listës/pronave qe do ti nënshtrohen procesit te inventarizimit, plotësimit, përditësimit dhe ndjekjen e procesit deri ne regjistrimin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pronave ne regjistrin kadastral publik te pasurive te paluajtshme dhe pajisjen me certifikate për çdo pasuri", i ndryshuar me urdhrin nr.483 dt., 04/08/2023 ka hartuar listën totale dhe listën me 30 prioritete si dhe evidentuar në vijimësi problematikat dhe adresimin e tyre me qëllim zgjidhjen dhe regjistrimin e pronave.<br><br>7. MK, në cilësinë e institucionit përgjegjës për mbarëvajtjen e monumenteve të kulturës, të koordinojë me të gjithë aktorët në nivel qendror, rajonal dhe vendor për hartimin dhe miratimin e planeve sektoriale në nivel rajonal, planit të përgjithshëm vendor dhe planeve të detajuara vendore të zhvillimit për zonat e rëndësisë kombëtare të trashëgimisë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi dhe rekomandimeve të lëna nga KLSH, Ministria e Kulturës në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë që operojnë në fushën trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe institucioneve të tjera qendrore, lokale rajonale ka bërë të mundur deri tani dhe në proces:<br>Hartimin dhe miratimin e 2 Planeve të Menaxhimit të Pasurive Kulturore përkatësisht:<br>- Plani i Menaxhimit te Integruar të Parkut Kombëtar Butrint të miratuar me VKM nr. 583, datë 22.7.2020 për miratimin e planit të menaxhimit të integruar të Parkut Kombëtar të Butrintit.<br>- Plani i Menaxhimit të Pallatit të Brigadave të VKM Nr. 438 datë 22.06.2022, Botuar ne | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Fletoren zyrtare nr. 95 date 28.06.2022<br><br>Aktualisht:<br>- Në proces finalizimi drafti i planit të menaxhimit të zonës arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit (2023-2030)<br>- Në proces përgatitje drafti i Planit të Menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis.<br><br>8. DRTK Shkodër të hartojë dhe miratojë proceset e punës për menaxhimin e dokumentacionit arkivor në institucion, në përputhje me ligjin për arkivat dhe normat tekniko profesionale, me qëllim që të shmangë në të ardhmen problematika të ngjashme si ato të evidentuara nga auditimi.<br><br>- Urdhër nr. 275, datë 12.12.2023 i Drejtorit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të DRTK Shkodër për miratimin e Plan veprimit për vitin 2023 për arkivin e DRTK Shkodër.<br>- Shkresë nr. 381/1, datë 15.12.2022 Plan Veprimi viti 2023<br><br>9. MK, në bashkëpunim me institucionet e varësisë, të ngrejë një grup pune, me qëllim analizimin e shkaqeve që kanë sjellë degradimin, tjetërsimin ose dhe rrënimin e monumenteve të kulturës në vendin tonë, duke propozuar gjithashtu edhe zgjidhje konkrete, sipas prioriteteve dhe të buxhetuara për përmirësimin e atyre monumenteve që paraqesin riskun më të madh për tu zhdukur apo për të humbur vlerat kulturore e arkitektonike. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Shkodër ka bërë të mundur angazhimin e strukturave qendrore dhe vendore lidhur me situatën kritike si rezultat i përkeqësimit të kushteve klimatike për objektin Pasuri Kulturore "Ura e Matit".<br>Më poshtë hapat e ndjekur në vijimësi:<br>-Me Urdhër nr. 7 date 20.01.2023 "Për koordinimin e procesit për rehabilitimin e Urës së Matit (zogut) dhe ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës në kuadër të këtij procesi".<br>- Në zbatim të VKM nr. 188 datë 13.03.2019 "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shërbimeve” është kërkuar bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës lidhur me hartimin e projektit të emergjencës Projekti teknik i zbatimit për ndërhyrjen emergjente në objektin monument kulture “Ura e Matit”. Projekti i hartuar është miratuar dhe ndjekur te gjitha hapat sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor.<br>Në mungesë të fondeve të nevojshme në realizimin e këtij projekti Përmes Vendimit nr. 1 date 24.03.2023 “Për miratimin e fondit për zbatimin e projektit teknik të ndërhyrjes emergjente në objektin monument kulture Kategoria e I-rë “Ura e Matit” është bërë i mundur përftimi i fondit të emergjencës. Ministria e Kulturës është në proces të përgatitjes së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | prokurimit të fondit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 202 datë 07.04.2023 “Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Kulturës për vitin 2023, për financimin e projektit teknik të ndërhyrjes emergjente në objektin monument kulture Ura e Matit”. | | |
| 2 | 7.7.2023 | 1. Sa eshte numri total i personave qe kane perfituar nga skemat e mbeshtetjes financiare nga rninistria juaj per ngritjen e biznesit te tyre gjate periudhes janar- dhjetor 2022! Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj!<br><br>2. Sa eshte numri i te rinjve (15-29 vjeç) qe kane perfituar nga skemat e mbeshtetjes financiare nga ministria juaj per ngritjen e biznesit te tyre gjate periudhes janar- dhjetor 2022! Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj? | 20.7.2023 | “Bonusi i rijetësimit”, pjesë e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale, është një nisëm e përvitshme e Ministrisë së Kulturës / Qeverisë Shqiptare për restaurimin dhe rijetësimin e objekteve në qendra historike në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin. Kjo nismë është një ndihmë në formë granti, për të gjithë ata individë që janë pronar të një objekti në qendrat historike të qyteteve | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe kanë iniciativën për ta zhvilluar më tej atë duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal. Për vitin 2022, aplikuan dhe u mbështetën nëpërmjet kësaj nisme 40 projekte fituese në Shkodër, Krujë, Berat, Gjirokastër, Korçë, Përmet, Pogradec, etj. Nga 41 projekte fituese, 28 prej tyre (10 femra dhe 18 meshkuj) përfituan mbështetje financiare për aktivitete dhe biznes te cilat zhvillohen ne aktivitete si: -Bujtina, njësi shërbimi gastronomi, suvenir, galeri, escape room, etj.<br>Nga programi i mbështetjes financiare e Ministrisë së Kulturës, thirrja e pare e “Bonusit të Rijetësimit”, kanë përfituar 4 te rinj, prej te cilëve 3 meshkuj dhe 1 femër. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 15.7.2023 | Kopje të Vendimit dhe Raportit mbi vëzhgimin arkeologjik sipërfaqësortë realizuar, në lidhje me zbatimin e projektit Impianti Termik Lundrues I Përkohshëm, në Vlorë, Shqipëri, me vendodhje në Triport, Vlorë. | 17.7.2023 | Per projektin Impianti Termik Lundrues i Përkohshëm, në Vlorë, Shqipëri, me vendodhje në Triport, Vlorë, me zhvillues"KESH" sha, ju informojme se prane Intitutit Kombetar te Trashegimise Kulturore si institucioni pergjegjes, ne varesine e Ministrise se Kultures, nuk ka asnje aplikim dhe rrjedhimisht as vendimmarrje nga Keshilli Kombetar i Trashegimise Kulturore Materiale per vezhgim arkeologjik siperfaqesor. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka |
| 4 | 22.6.2023 | Na pajisni me kopje të proces-verbalit të vlerësimit dhe vendimit të Kolegjiumit për projekt-propozimet e përzgjedhura nga Thirrja e vitit 2023, për të cilat Kolegjiumi ka kërkuar miratim nga ministri përgjegjës për kulturën për t'u mbështetur me fonde | 23.8.2023 | 1. Në lidhje me kërkesën tuaj për pajisje me tabelen shpjeguese per secilin nga projektet fituese per vitin 2023, lutem gjeni bashkëlidhur tabelën me shpjegimet përkatëse.<br><br>2. Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | publike. (Bazuar në Rregulloren e miratuar, sipas Urdhërit nr. 123, datë 28.02.2023, konkretisht në zbatim të neneve 10 dhe 11 (pika 3 e 4).<br><br>Na pajisni me kopje të Urdhërit të Ministrit të Kulturës nr. 36 datë 24.01.2022.<br><br>Na pajisni me kopje të Rregullores së Kolegjiumit në vlerësimin dhe përcaktimin e projekt-propozimeve fituese, në kuadër të Thirrjes 2022. | | bazuar në nenin 17 të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" nga tabela bashkëlidhur janë hequr të dhënat personale të fituesve dhe të dhënat të cilat cënojnë të drejtat e autorit. | | |
| 5 | 18.5.2023 | Cilat janë 186 projektet fituese të shpallura nga thirrja e fillim-vitit 2023?<br><br>Sa është buxheti i propozuar për secilin nga projektet nga aplikantët?<br><br>Cilat janë projektet për të cilat është pranuar | 24.7.2023 | Informacioni i kërkuar është vendosur në dispozicion të kërkuesit. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | buxheti sipas propozimit dhe për cilat projekte është negociuar buxheti?<br><br>Për cilat projekte ka përfunduar procesi i negocimit dhe sa është vlera përfundimtare e projektit? | | | | |
| 6 | 25.7.2023 | Cilat janë monumentet historike të cilat po rikontruktohen aktualisht nga IKTK në bashkëpunim me bashkitë si edhe ato të cilat janë nën mbikëqyrjen e institutit?<br><br>A është Kalaja ( kështjella ) e Bashtovës njëra prej tyre?<br><br>Është kjo kështjellë pjesë e projektit 100 fshatra? Nëse po: Cila është kompania fituese e këtij rikonstruksioni? | 26.7.2023 | 1. Me poshte do te gjeni  proceset e punës që ndjek IKTK, duke pëfshirë projektet me donatorë, në proces zbatimi, konsultimi apo hartimi:<br>**a) Kisha e Shën Ndojit në Kepin e Rodonit, restaurim**<br>*Mbikëqyrës:* IKTK<br>*Procesi:* Përfunduar punimet<br>*Komente:* Përfunduar Janar 2022<br>**b) Kisha e Manastirit e Rubikut, restaurim**<br>*Mbikëqyrës:* DRTK Shkodër<br>*Procesi:* Përfunduar punimet | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Cila është kompania supervizore?<br><br>Kur është parashikuar nisja dhe përfundimi i punimeve?<br><br>A kanë përfunduar ato?<br><br>Sa është fondi i parashikuar për këtë rikonstruksion?<br><br>A do të duhet një fond shtesë për përdundimin e këtyre punimeve? Nëse po, sa do të jetë ai dhe nga cili institicion do të alokohet?<br><br>Është aktualisht e vizitueshme Keshtjella e Bashtovës?<br><br>A janë (dhe ku janë) të afishuara gjetjet nga arkeologët për këtë keshtjellë? | | *Komente:* Përfunduar 2021<br>**c) Godina e ish Arqipeshkëvisë, Delbnisht**<br>*Mbikëqyrës:* IKTK<br>*Procesi:* Në proces zbatimi<br>*Komente:* Janë realizuar punimet e restaurimit në masën 80 %. Punimet e realizuara deri tani:<br>1. Pastrim nga bimësia;<br>2.Ngritje kanrieri;<br>3. Prishje e suvatimit;<br>4.Prishje shtresash;<br>5. Transport mbeturinash;<br>6. Restaurim çatie;<br>7. Pastrim fugature.<br>8. Punime murature<br>9. Punime shtresash<br>10.Punime suvatimi<br>11.Punime dyer dritare<br><br>**d) Rrënojat e kishës së Shën Mërisë, Mamurras**<br>*Mbikëqyrës:* -<br>*Procesi:* Është miratim projekti. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Komente:* Në pritje të njoftimit e përcaktimit të fituesit të zbatimit të punimeve dhe njoftimit të fillimit të punimeve.<br>**e) Kalaja e Bashtovës, restaurim dhe rijetëzim**<br>*Mbikëqyrës:* IKTK<br>*Procesi:* Në proces zbatimi<br>*Komente:* Punimet në kantierin e objektit “Kala e Bashtoves” kanë filluar në datë 02.09.2022 dhe do të përfundojnë 2 korrik 2023. Punimet nuk kanë përfunduar ende, është aplikuar për shtyrje afati dhe Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka miratuar kërkesën për shtyrje afati të punimeve për 6 muaj.<br>2. Jo. Kantieri është dorëzuar për zhvillimin/zbatimin e punimeve.<br>3. Jo. Gjetjet arkeologjike janë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | akoma në proces studimor, nuk janë afishuar. | | |
| 7 | 24.7.2023 | Informacion lidhur me zbatimin e “Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëpunim në Fushën e Kinematografisë dhe Aktiviteteve Audio-Vizuale në Ballkanin Perëndimor” | 3.8.2023 | 1. Bazuar pikës 2, të nenit 14, të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon që “marrëveshja ndërkombëtare shtypet në dy ose më shumë kopje të njëjta, në varësi të palëve nënshkruese, në gjuhët e palëve. Marrëveshja mund të shtypet edhe në një gjuhë të tretë ose vetëm në një gjuhë të tretë, në rast se palët bien dakord. Secila kopje ka vlerën e origjinalit”, ky memorandum është nënshkruar vetëm në gjuhën angleze;<br>2. Memorandumi në fjalë është marrëveshje ndërkombëtare ndërinstitucionale dhe bazuar pikës 3, të nenit | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 13, të ligjit nr. 43/2016, “marrëveshjet ndërkombëtare në emër të ministrive, institucioneve qendrore e vendore, si dhe të enteve publike nuk miratohen në parim me vendim të Këshillit të Ministrave…”;<br>3. Marrëveshja zbatohet nga Ministria e Kulturës/institucionet në varësi të saj si dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK);<br>4. Lidhur me Komisionin e Përbashkët, sqarojmë së ky Komision aktualisht nuk është krijuar, ndërkohë, ju bëjmë me dije se në zbatim të kësaj marrëveshjeje, Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka zhvilluar aktivitete në fushën e kinematografisë me Republikën e Serbisë dhe Republikën e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Maqedonisë së Veriut sipas pikave të mëposhtme të memorandumit:<br>Neni 2<br>Pika 1 – Shkëmbimi i praktikave zhvillohet në takimet e vashdueshme gjatë vitit, kryesisht gjatë markatës së filmit në Berlin dhe Cannes, si dhe mbledhjeve të organizatave Eurimages, SEE Cinema Netëork dhe European Film Promotion, forumeve në festivale ndërkombëtare etj.<br>Pika 2/4/8 – QKK promovon vazhdimisht në hapësirat digjitale dhe përtej, festivalet dhe aktivitetet e Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, për të mundësuar dhe rritur shfaqjet e filmave reciprokë në eventet e secilit shtet.<br>Pika 6 – QKK merr pjesë në forume apo | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | evente të përbashkëta në fushën e audiovizualit, për të diskutuar problematika të vendeve të rajonit në elementë të ndryshëm të sektorit, me qëllim ngritjen e strategjive të përbashkëta. Një prejt tyre në veçanti është “Networku i dokumentarit”, i<br>cili mblidhet në Shkup gjatë festivalit “MAKEDOX”, ku po përgatitet një fokus i filmave ballkanikë që do të prezantohet vitin tjetër në festivalet më të mira europiane të dokumentarit.<br>Pika 12 – QKK promovon online dhe on site në merkatat e filmit ndërkombëtar projektet e përbashkëta, me talente ose financime nga institucionet e filmit në shtetet pjesëmarrëse në memorandum.<br>Neni 3/ Neni 2 (Pika 3/5/10) | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | QKK është në komunikim me institucionet partnere dhe promovon thirrjet për fonde bashkëprodhimesh midis vendeve. Në thirrjen e fundit u financua 1 (një) bashkëprodhim me Maqedoninë e Veriut Aktualisht kanë aplikuar për fond në Maqedoninë e Veriut 2 projekte shqiptare, për të cilat pritet rezultati shumë shpejt. Gjithashtu, në zbatim të marrëveshjeve të nënshkruara në kuadër të nismës "Open Balkan", me bashkëpunimin e ngushtë ndërinstitucional të Palëve, nga data 13 Korrik 2023 deri më 12 Gusht 2023 në Qendrën Kulturore të Serbisë në Paris, është organizuar dhe qëndron e hapur ekspozita "Substrates", me punime të tre | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | artistëve nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.<br>Për sa më sipër, bëjmë me dije se Ministria e Kulturës dhe institucionet e saj të varësisë janë angazhuar në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në fushën e kulturës dhe disponojnë kapacitetet e nevojshme njerëzore, administrative dhe logjistike për implementimin e tyre. | | |
| 8 | 26.7.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me vlerat financiare që kanë përfituar fituesit në kuadër të thirrjes për projektpropozime në fushën kulturore për vitet 2020, 2021,2022. | ___ | ___ | ___ | ___ |
| 9 | 1.8.2023 | Informacion për sa më poshtë vijon për kalanë e Bashtovës:<br>Kur është miratuar kërkesa për shtyrjen e afateve të punimeve? | 7.8.2023 | Kerkesa per shtyrjen e afatit te punimeve eshte miratuar ne Keshillin Kombetar te Trashegimise Kulturore Materiale me ane te | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mund të më bashkangjisni këtë vendim?<br>A është kërkuar (dhe nëse po sa) rialokim fondi për vijimin e punimeve?<br>Përse nuk ka mjaftuar fondi fillestar?<br>Cila është përbërja e ekipit të arkeologëve dhe ekspertëve që po punojnë në këtë kantier?<br>Janë aktualisht duke u kryer punime në Kalanë e Bashtovës?<br>Cili është projekti për këtë rikonstruksion dhe si do të ndikoi ai në zhvillimin e trashëgimisë kulturore të Shaipërisë dhe komunitetit? | | vendimit nr. 416, date 18.07.2023<br>Ne kuader te projektit te miratuar ne KKTKM, nëpërmjet ndërhyrjeve të propozuara nga grupi i punës, pritet që jo vetëm Kalaja e Bashtovës si monument por edhe zona e mbrojtur arkeologjike në të cilën ndodhet, të fitojnë një riorganizim, rehabilitim, konsolidim dhe ruajtje të vlerave monumentale dhe shpirtërore të trashëguara në breza, të cilat të kenë mundësinë të promovohen gjerësisht për publikun vendas e të huaj. Më konkretisht, pritshmëritë e projektit janë si vijon:<br>Rimëkëmbja e zonës dhe monumentit me vlera domethënëse kulturore të dëmtuara nga tërmeti i 2019.<br>Të përkrahë zhvillimin social-ekonomik të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | zonës dhe të ofrojë mbështetje për institucionet lokale në procesin e ruajtjes, menaxhimit dhe promovimit të trashëgimisë.<br>Të sjellë ndërgjegjësim mbi rendësinë e trashëgimisë kulturore, jo vetëm ne shkallë institucionale por edhe në publikun e gjerë. | | |
| 10 | 1.8.2023 | Lidhja e kulturës me turizmin, si po arrihet një bashkëpunim më i lartë në këtë sektor për të arritur një rritje më të lartë ekonomike? Ju lutem përmendni hapat konkret që po ndërmerrni në këtë drejtim.<br>Nxitja e prodhimit vendas: Çfarë hapa po ndërmerrni për të inkurajuar më shumë turistë të blejnë produkte vendase, si punime artizanale etj? | 7.8.2023 | Në zbatim të politikave strategjike të Qeverisë Shqiptare si dhe Strategjisë Kombëtare për Kulturën (SKK) 2019 –2025, nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet qendrore në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore, në varësi të saj, janë marrë disa hapa në mbështetje të zhvillimit të kulturës kombëtare, promovimit të trashëgimisë sonë kulturore, artit elitar dhe kulturës sonë të shkruar, të cilat gërshetohen me njëra | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tjetrën si një motor zhvillimi në funksion të paketës së turizmit kulturor.<br><br>Qëllimi kryesor është pasurimi i hapësirave publike përgjatë sezonit turistik veror 2023, në mbështetje të politikave prioritare të shtetit shqiptar, për pasurimin e paketës turistike, përmes aktiviteteve artistike-kulturore, si dhe në interes të promovimit të aseteve kombëtare të trashëgimisë sonë kulturore. Ministria e Kulturës si një institucion publik qendror i artit dhe kulturës ka si qëllim dhe objekt kryesor të veprimtarisë së saj vlerësimin e rëndësisë së artit dhe pasurimin e hapësirave publike në ruajtjen, promovimin e identitetit kulturor kombëtar si dhe mbështetjen e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | krijimtarisë të artistëve vendas dhe të huaj. Gjithashtu, marrë në konsideratë fluksin e vizitorëve të huaj dhe vendas në kuadër të sezonin turistik, fluks i ardhur në rritje gjatë viteve të fundit, është e rëndësishme organizimi i aktiviteteve kulturore kryesisht në zonat bregdetare apo në vende me trashëgimi të pasur kulturore, me qëllim tërheqjen e sa më shumë turistëve, veçanërisht atyre artdashës, duke promovuar artin, kulturën dhe trashëgiminë e vendit tonë. Në këtë mënyrë turistët do të njihen me vlerat tona më përfaqësuese, si dhe elementeve të tjera artistike dhe letrare, që na karakterizojnë ne si popull.<br>Eventet e miratuara janë pjesë e programit veror të turizmit dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kanë si qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale. Kalendari me aktivitete kulturore ka në fokus përmirësimin e eksperiencës së turistëve duke ofruar një kombinim të veprimtarive tërheqëse për të njohur dhe shijuar trashëgiminë kulturore. Eventet e organizuara në kuadër të këtij programi synojnë të sjellin bashkë elementët kryesorë të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë artin, muzikën, gastronominë, festat popullore, traditat dhe artizanatin lokal. Përmes këtyre eventeve, turistët kanë mundësinë të njohin vlerat unike të kulturës vendase, të përjetojnë traditat autentike dhe të krijojnë lidhje të reja | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | me komunitetin lokal. Kjo promovon jo vetëm turizmin e qëndrueshëm, por gjithashtu edhe zhvillimin ekonomik dhe kulturor të Shqipërisë.<br><br>Programi veror në funksion të turizmit është i përqendruar në përmirësimin e eksperiencës së turistëve në të gjitha lokacionet bregdetare. Këto evente do të kombinojnë bukurinë natyrale të bregdetit me pasurinë e trashëgimisë kulturore të zonës. Turistët do të kenë mundësinë të marrin pjesë në koncerte, shfaqje tradicionale, ekspozita artistike, demonstrime artizanale dhe festa popullore, të cilat do t'u japin një përjetim të veçantë të kulturës dhe traditave vendase. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kjo qasje e gjerë e eventeve u siguron që turistëve të kenë një përvojë të plotësisht tërheqëse dhe të pasuruar nga bukuria natyrore dhe trashëgimia kulturore në të gjitha destinacionet bregdetare.<br>Gjithashtu, eventet që vijnë në kuadër të programit veror të turizmit për promovimin e trashëgimisë kulturore ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore të një vendi.<br>… | | |
| 11 | 2.8.2023 | Kërkoj të më vihen në dispozicion relacionet përfundimtare të VKM-ve të mëposhtme, të miratuara me propozim të Ministrit të Kulturës, si në vijim:<br>“Për lirimin nga detyra të kryetarit të Qendrës | 15.8.2023 | Dokumentacioni është vënë në dispozicion. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kombëtare të Kinematografisë"<br>"Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e miratuar për vitin 2023, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Shërbimit Informativ të Shtetit"<br>"Për funksionimin, organizimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë të Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim"<br>"Për përcaktimin e listës së pajisjeve dhe tarifave për shpërblimin e arsyeshëm për riprodhimin e veprave të autorit për përdorim privat ose përdorim tjetër personal" | | | | |
| 12 | 4.9.2023 | Kërkoj vendosjen në dispozicion të relacioneve përfundimtare të VKM-ve të mëposhtme, të miratuara me propozim të Ministrit të Kulturës:<br>"Për kalimin në përgjegjësi | 12.9.2023 | Dokumentacioni është vënë në dispozicion. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | administrimi të Ministrisë së Kulturës të pronës me emërtimin “Kalaja e Lëkursit”, me numër pasurie 26/144, 26/139, 26/487, zona kadastrale 8642, Sarandë” | | | | |
| 13 | 14.9.2023 | Sa është numri i monumenteve kulturore në vendin tonë dhe sa për secilën kategori?<br>Sa prej tyre janë shpallur “Të mbrojtura nga shteti”?<br>Cilat janë monumentet kulturore që ndodhen në rrezik për të degraduar totalisht? (numri dhe një listë me emrat e tyre)<br>A ka Ministria e Kulturës një plan për rijetësimin e këtyre monumenteve?<br>Nëse po, cfarë parashikon ky plan?<br>Nëse ka nisur zbatim, në cilat monumente ka nisur rijetësimi? | 26.9.2023 | Lista e monumenteve të kulturës, përcaktuar sipas kategorive, vendodhjes dhe urdhërat e shpalljes është e afishuar në faqen zyrtare të Intitutit Kombetar te Trashegimise Kulturore. Këtë material mund ta aksesoni në linkun: https://iktk.gov.al/site/pasuri-kulturore/ .<br><br>Mbështetur në Ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë’’, neni 5, pika 36 e tij “Monument kulture” është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti. Të | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | gjitha monumentet që gëzojnë këtë status, kategoria e I-rë dhe kategoria e II-të, mbrohen nga shteti.<br><br>Bashkëlidhur gjeni listën.<br><br>“Bonusi i rijetëzimit”, pjesë e Fondit Kombëtar të Kujdesit të Trashëgimisë Kulturore Materiale, është një nisëm e pervitshme e Ministrisë së Kulturës / Qeverisë Shqiptare për restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve në qendra historike në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin.<br><br>Kjo nismë është një ndihmë në formë granti, për të gjithë ata individë që janë pronar të një objekti në qendrat historike të qyteteve dhe kanë iniciativën për ta | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | zhvilluar më tej atë duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal. “Bonusi i rijetëzimit”, si një fond i përvitshëm, do të mbështesë pronarët dhe përdoruesit e ligjshëm të objekteve që janë pjesë përbërëse e ansambleve historike urbane, qendrave historike, zonave arkeologjike ose kanë statusin pasuri kulturore.<br><br>Për sa më sipër ju ftojmë të vizitoni linkun e mëposhtëm për më tepër detaje në lidhje me këtë nisëm të përvitshme të Ministrisë së Kulturës: https://ëëë.kultura.gov.al/ | | |
| 14 | 13.9.2023 | Informacion ne lidhje me fondin e perfituar nga nje Fondacion ne kuader te Thirrjes per projetkpropozime ne fushen e cultures. | 25.9.2023 | 1.Fondacioni është i regjistruar si organizatë jofitimprurese dhe në nenin 6, pika a të Statutit të tij, citohet se ka për qëllim financimin e | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | aktiviteteve kulturore dhe artistike të cilat transmetohen live para publikut ose përmes televizionit. Me kërkesë drejtuar Ministrisë së Kulturës, datë 14.7.2022, Drejtorja Ekzekutive e këtij Fondacioni i është drejtuar Ministrisë së Kulturës për mbeshtetje të projekt-idesë "Trashëgimia, krenaria jone, aty ku e shkuara takohet me të ardhmen" shoqëruar me dokumentacionin ligjor të Fondacionit, përshkrimin e hollësishëm të projektidesë dhe tabelën e kostove financiare të projektit. 2. Arsyet pse është dhënë ky fond është sepse ky projekt është në përmbushje të politikave dhe qëllimeve të Ministrisë së Kulturës për ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | trashëgimisë kulturore, pas paraqitjes së kërkesës, projektidesë dhe dokumentacionit ligjor të fondacionit, jo televizionit privat kombëtar.<br>3. Baza Ligjore për mbështetjen financiare të këtij projekti është ligji 10352, 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar.<br>4. Interesi publik i përmbushur është tërheqja e vëmendjes së publikut drejt trashëgimisë kulturore, monumenteve, muzeve, kostumeve tradicionale, traditave dhe qyteteve muze,përmiresimi i imazhit të Shqipërisë përmes traditave dhe trashëgimise së saj, nxitja e krenarisë kombetare etj.<br>5. Gjatë 3 viteve të fundit, këtij Fondacioni nuk i është dhënë mbeshtetje financiare nga Ministria e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kulturës për projekte të tjera. | | |
| 15 | 21.9.2023 | Ju drejtohem me kërkesë për dhënien e lejes për kërkim të monedhave me detektor metali në zonën e plazheve pranë Durrësit.<br>Planifikoj të kryej kërkimin në një sipërfaqe prej 1000 metrash katrorë në periudhën nga 1 gusht 2023 deri më 31 gusht 2024. Për kërkim do të përdor detektor metali Garett ACE 250.<br>Meta e kërkimit është gjetja e monedhave të sotme lekë dhe euro, si dhe të ndryshme sende metalike të humbura. Gjithashtu, do të mbledh të gjitha sende metalike të mbeturinave.<br>Do të doja të dija nëse ka ndonjë ligj që rregullon këtë lloj aktiviteti. | 28.9.2023 | | Kjo kërkesë është deleguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. | Nuk ka. |

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr. Rendor [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 30.9.2023 | 1. Kur kanë nisur punimet për rikonstruksionin e Muzeut Arkeologjik Durrës?<br><br>2. Cili ishte afati fillestrar për përfundimin e këtyre punimeve?<br><br>3. Sa është vlera e fondit për rikonstruksionin e Muzeut Arkeologjik Durrës?<br><br>4. Përse nuk kanë përfunduar ende punimet? | 13.10.2023 | Punimet për restaurimin e këtij objekti kanë nisur në muajin Nëntor të vitit 2022.<br>Afati i punimeve sipas grafikut të punimeve të miratuar në KKTKM ka qenë 11 muaj.<br>Vlera e Kontratës: 348,368,591 Lekë.<br>Arsyet që kanë patur impakt në shtyrjen e afatit të punimeve të ndërtimit kanë qënë:<br>a. Zhvendosja dhe dokumentimi i artifakteve. Procesi i zhvendosjes ka marrë kohë për arsye të gjendjes delikate dhe | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail. | Nuk ka |

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5. Kur pritet të përfundojnë punimet për këtë muze?<br><br>6. Si do të procedohet në vijim më shtyrjen e afatit dhe kostot? Do të ketë kosto të tjera nga ato që<br><br>janë parashikuar nga fondi fillestar?<br><br>7. Cili është plani për restaurimin e tij, shembuj me foto, pamje të projektit të përfunduar, ose ilustrime të tjera të ngjashme. | | numrit të madh prej 3000<br>artifakte.<br>b. Punime të paparashikuara në përforcimin strukturor të objektit ka sjellë rishikimin e ndërhyrjeve duke kryer përforcime shtesë në objekt.<br>c. Në projekt parashikohet ndërtimi i një shtesë të re në oborrin e pasëm të objektit i cili është në proces shqyrtimi në Këshillin Kombëtar të Territorit.<br>5. Afati i përfundimit ishte Tetor 2023. UNOPS, si autoriteti kontraktor per zbatimin e punimeve, ka aplikuar për kërkesë për afat shtesë prej 11 muajsh.<br>6. Kërkesa për shtyrjen e afatit të punimeve do të jetë objekt diskutimi dhe<br>miratimi pranë KKTKM-së. Kostot e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | rikonstruksionit te objektit mbulohen nga Bashkimi Europian nëpërmjet programit EU4Culture. Zbatimi i projektit nuk do të ketë kosto shtesë nga vlera fillestare.<br>7. Bazuar ne Kreun IV "Kufizimi i të drejtës pë informim", neni 17, pika 1, gërma 'c' e ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", projekti është realizuar nga studio private dhe si i tillë ky informacion kufizohet.<br>Shenim: Objekti i Muzeut Arkeologjik të Durresit nuk është monument kulture, sipas parashikimeve në Ligjin Nr. 27/2018 si dhe VKM nr. 1125, datë 30.12.2020, dhe për këtë arsye nuk mund te supervizohet apo kolaudohet nga IKTK. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 29.9.2023 | Informacion ne lidhje me projektet qe mbeshteten nga MK, analizim i aspekteve te ndryshme te artit pamor nga MK. | 27.10.2023 | 1. Ministria e Kultures ka kryer analiza mbi ndikimin afatgjatë të mbështetjes financiare të projekteve me Thirrje. Çdo vit, Ministria e Kulturës analizon rezultatet e projekteve, ndikimin që kanë patur në publikun artdashës dhe komunitetin e artistëve, punësimin e artistëve të rinj dhe artistëve në përgjithësi, barazinë gjinore, diversitetin kulturor, diskriminimin racor etj. Një nga analizat kryesore është edhe vijueshmëria e projektit, qëndrueshmëria në kohë dhe inovacioni.<br>2. Buxheti i alokuar për skemën e projekteve me Thirrje për secilin vit është si vijon:<br>a) 2019: 12.303.000 lekë;<br>b) 2020: 33.000.000 lekë;<br>c) 2021: 79.840.000 lekë; | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkrese. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | d) 2022: 140.364.600 lekë;<br>e) 2023: 165.120.000 lekë.<br>3. Procedura e hartimit të Thirrjes bazohet në objektivat, qëllimet dhe politikat e Ministrisë së Kulturës. Në bazë të ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, vit pas viti shpallet paketa e Thirrjes e cila përmban: Udhëzuesin e Thirrjes (prioritetet, tipologjitë e veprimtarive, afatet kohore, mënyrën e aplikimit, vizibilitetin) formularin e aplikimit, formularin e buxhetit, kalendarin e aktiviteteve, listën e dokumentacionit të kërkuar). Kjo paketë shpallet online në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës.<br>4. Anëtarët e Kolegjiumit i cili shqyrton dhe vlerëson aplikimet dhe i | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | propozon Ministrit të Kulturës listën për projektet fituese, zgjidhen në bazë të ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, neni 27. Veprimtaria e tyre për përzgjedhjen mbështetet në Rregulloren e funksionimit të Kolegjiumit.<br>5. Procedura e raportimit për projektet përgjatë realizimit bazohet në komunikime lidhur me ecurinë, datat e zhvillimit, vendin, pjesëmarrjen dhe elemente të tjera specifike. Raportimi në përfundim të realizimit të projektit, pas monitorimit të aktiviteteve fizikisht ose përmes publikimeve në media, ëeb site, rrjete sociale etj, përmban:<br>a. raport narrativ; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | b. raport financiar;<br>c. kontrata, fatura të fiskalizuara dhe kalime bankare për shërbime me të tretë;<br>d. kontrata, kalime bankare dhe pagesë TAP për individë;<br>e. link, faqe ëeb dhe materiale të tjera dokumentuese të realizimit të projektit.<br>6. Në lidhje me krijimin e Qendrës për Hulumtim të Industrisë Kulturore dhe Krijuese ju bëjmë me dije se aktualisht kjo Qendër nuk është ngritur, por është një ndër prioritetet e Ministrisë së Kulturës në të ardhmen. Qendra për Hulumtimin të Industrisë Kulturore dhe Krijuese do të plotësojë hendekun e madh, që ekziston në lidhje me hulumtimet në fushën e kulturës dhe të indikatorëve që lidhen me to. Nëpërmjet ngritjes së | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | këtij institucioni synohet krijimi i një sistemi qendror statistikor për të dhënat e kulturës dhe të industrisë kreative në Shqipëri, grumbullimin dhe publikimin e të dhënave të kulturës nga të gjithë aktorët publik dhe privat, krijimin e platformave promovuese për turizmin kulturor, etj. Në mbështetje të artit, dhe në vijim të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025, Ministria e Kulturës,në planet e saj afatshkurtër dhe afatgjatë, për të patur dhe krijuar një mjedis të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës, gjithmonë ka synuar gjithë përfshirjen dhe mbështetjen e krijimtarisë së artistëve shqiptarë, industrinë kreative, mbështetjen e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | krijuesve dhe organizatave të pavarura kulturore, me qëllim zhvillimin dhe promovimin e sektorëve kulturorë dhe mbështetur pavarësimin e tyre në tregun e sotshëm.<br><br>Referuar Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025, konkretisht Industritë Krijuese, konsiderohet një sfidë e cila duhet të trajtohet përmes bashkëpunimit të ngushtë mes aktorëve të rëndësishëm për orientim të politikave kulturore dhe reformave ligjore për stimulim dhe lehtësim financiar, ndërlidhur fort me teknologjinë digjitale, duke synuar drejt ndërtimit të kapaciteteve për prodhim dhe shpërndarje të shërbimeve dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | produkteve kulturore dhe krijuese.<br>Për të thelluar dialogun politik në kulturë, për çështje me interes të përbashkët, të tilla si promovimin e diversitetit kulturor, industritë kulturore dhe kreative, artet bashkëkohore, trashëgiminë kulturore, Shqipëria nëpërmjet Ministrisë së Kulturës, angazhohet të thellojë anëtarësimin në rrjete të rëndësishme të zgjerimit dhe mbështetjes së potencialit krijues artistik, që ndihmojnë:<br>a) Për të lehtësuar shkëmbimin e rregullt të praktikave të mira dhe informacionit mbi çështjet kulturore;<br>b) Për të treguar një vëmendje të veçantë për interesat, nevojat dhe pritjet e brezit të ri,<br>c) Për promovimin e njohurive dhe ndërtimin e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kapaciteteve në veçanti, në lidhje me kulturën dhe artin në mjedisin digjital dhe inovativ. Në këtë drejtim, Shqipëria po sheh rezultate të kënaqshme në përvojat e para të fituara përmes Programit të Bashkimit 'Evropa Krijuese', nën-programeve "Kultura" dhe "Media", të koordinuara nga Ministria e Kulturës . Ky angazhim përbën një faktor kyç në zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet vendeve të rajonit, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal dhe bashkëpunimin e qëndrueshëm ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.<br>7. Në lidhje me pyetjen nëse Ministria e Kulturës zotëron një regjistër të artistëve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pamorë dhe organizatave kulturore në Shqipëri, ju informojmë se nuk disponojmë një regjistër të tillë sepse nuk është një detyrim që buron nga legjislacioni në fuqi.<br>8. Në lidhje me pyetjen çfarë ndihme ka dhënë Ministria e Kulturës për artistët pamorë gjatë pandemisë Covid-19, 13, ju bëjmë me dije se Ministria e Kulturës i kushton një vëmendje të veçantë të gjitha fushave të artit dhe kulturës. Gjatë Pandemisë Covid 19, Ministria e Kulturës e orientoi nbështetjen për artistët, OJF, Shoqata të ndryshme, individë, persona fizikë drejt aktiviteteve online. Fituesit e Thirrjes për projekt propozime janë lehtësisht të aksesueshëm në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 9. Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare dhe Angazhimeve të ndërmarra nga Ministria e Kulturës në kuadrin e hartimit dhe përmirësimit të akteve me fuqi ligjore dhe nënligjore, si dhe referuar përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e artit dhe kulturës ju bëjmë me dije se Ministria e Kulturës në 2023 ka ndërrmarë një iniciativë të rëndësishme, siç është Ligji "Për pensionet e profesioneve të vështira" ku përfshihet ulja e moshës së pensionit për disa profesione të vështira të artistëve, kontribuese direkt në pasurimin e fondit të artit dhe kulturës Kombëtare. | | |
| 3 | 9.10.2023 | Në cilën fazë është projekti I publikuar në muajin prill 2023? Kur do të fillojë puna me | 27.10.2023 | Ministria e Kulturës ka marrë masat për zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rehabilitimin e Urës së Matit? | | "Ndërhyrje emergjente në Urën e Matit" në përputhje me legjislacionin në fuqi; Puna për rehabilitimin e Urës së Matit do të fillojë menjëherë pas lidhjes së kontratës me fituesin në përfundim të fazës prokurimit publik. | | |
| 4 | 10.10.2023 | 1) Në sa nga kalatë, keshtjellat, monumentet e kulturës dhe zonat e mbrojtura kulturore të Shqipërisë ndodhen brenda territorit të tyre bare dhe restorante, ose të paktën njëri prej këtyre bizneseve?<br><br>2) Kur janë dhënë lejet për këtë aktivitet dhe në cilat rrethana, mbështetur në cilat ligje apo rregullore? A ka pasur një garë të hapur? Nëse janë koncesione, në cilat rrethana dhe mbi | 14.12.2023 | 1.Baza ligjore për zhvillimin e procedurave për dhënien me qera të këtyre pasurive kulturore objekt kërkese, është Udhëzimi nr. 5110, datë 13.10.2015 "Për dhenien me qira dhe menyren e administrimit te monumenteve te kultures me qëllim rijetezimi" i ndryshuar, i Ministrit te Kultures. 2.Akivitetet kulturore në pasuri kulturore dhe muze kombëtar të cilat janë miratuar me urdhër të ministrit | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ç’procedura janë miratuar?<br><br>3) Kërkoj të më vihen në dispozicion një kopje e liçencave të dhëna për këto biznese për përdorimin e ambienteve në fjalë.<br><br>4) Cili është kuadri ligjor i cili e lejon liçencimin e bizneseve të kësaj natyre në këto monumente/zona/instit ucione?<br><br>5) Cilat janë problematikat që sjellin për këto monumente, kostot në mjedisin e tyre këto aktivitete dhe cilat janë përfitimet që sjell për shtetin shqiptar ky aktivitet tregtar apo shërbim?<br><br>6) A ka Ministria e Kulturës në vend një strategji për mitigimin e dëmeve potenciale dhe investimit në përmirësim të situatës | | përgjegjës për trashëgiminë kulturore zhvillohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe kontratën e lidhur mes subjektit dhe institucionit përgjegjës që administron pasurinë kulturore. Permes aktiviteteve kulturore promovohen vlerat e trashëgimsië kulturore si dhe mbështeten individë/subjekte aktiviteti i të cilave ka në fokus promovimin e këtyre vlerave. Gjatë zhvillimit të aktiviteve, institucionet në varësi të Ministrisë së Kulturës ngarkohen përmes urdhrit të ministrit që miraton zhvillimin e aktivitetit të moniotorojnë aktivitetin me qëllim moscënimin e pasurisë kulturore.<br>3. Kërkesat për zhvillim të aktiviteteve kulturore dhe me karakter edukativ në | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | nga dëmet potenciale të arhdura nga këto biznese? Nëse po, kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje.<br><br>7) Nëse e krahasojmë me përvojën e vendeve të tjera do të shohim se ne site arkeologjike nuk ka aktivitet te kesaj natyre. Pse janë lejuar në Shqipëri?<br><br>8) A është menduar të mbyllen e të zëvëndësohen me një mënyrë tjetër të sjelljes së përfitimeve si psh, bileta për turistët? | | pasuri të trashegimisë kulturore dhe muze kombëtar shqyrtohet vetëm pasi të jetë plotësuar dhe dorëzuar online formulari në platformën e-albania. Referuar aktivitetit të propozuar, kërkesa i përcillet për vlerësim institucionit që ka në përgjegjësi administrimi pasurinë ku propozohet të zhvillohet aktiviteti. Sipas rastit propozimi dhe dokumetnacioni i dorëzuar nga subjekti përcillet per vlerësim dhe vendimarrje edhe në këshillat përkatës në Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Referuar mendimit dhe vendimarrjes nga strukturat e sipërcituara procedura në rast miratimi finalizohet me Urdhrin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore i cili ngarkon | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | institucionin për zbatimin dhe monitorimin e aktivitetit në përputhje me kontratën që lidhet mes palëve.<br>4.Referuar kuadrit ligjor në fuqi, ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" dhe VKM Nr. 857, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të konkurrimit, formën e kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike”, Ministria e Kultures nuk ka zhvilluar asnje procedure dhe si rrjedhoje nuk ka miratuar asnjë aktivitet biznesi (bar-restorante) në këto site.<br>5.Ministria e Kulturës në zbatim të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore (ligji nr. 27/2018 "Për trashegiminë kulturore dhe muzetë") ka miratuar Urdhrin nr. 715 datë 10.12.2019 "Për miratimin e formatit, çmimit, kategorisë dhe mënyrës së emetimit të biletave për muzetë kombëtar, muzetë qendror publik, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore" dhe Urdhrin nr. 518 datë 12.09.2019 "Për miratimin e formatit dhe çmimit të biletës online për institucionet e trashëgimisë kulturore të cilat aplikohen bileta elektronike" (i ndryshuar). Gjithashtu aksesi në site dhe monumente të kulturës në sherbim të turistëve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe vizitorëve, rezervimi mundësohet edhe përmes shërbimit nga platforma online: Myticket.al. Të ardhurat e gjeneruara nga shitja e biletave në monumente dhe muze administrohet në baze të kuadrit ligjor në fuqi. | | |
| 5 | 11.10.2023 | 1. Cilat do të jeni hapat për restaurimin dhe perforcimin e mureve të Manastirit të Ardenicës?<br><br>2. A do të filloni ndërhyrjen për vitin e ardhshëm?<br><br>3. A keni ju gati një projekt për të ndërhyrë? | 2.11.2023 | Manastiri i Shën Mërisë në Ardenicës është shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë nga:<br>*1.Instituti i Shkencave me vendim Nr.586, datë.17.03.1948;*<br>*2.Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës me vendim Nr.6, datë.15.01.1963;*<br>*3.Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendim Nr.68/7 datë.30.05.1970;*<br><br>*4.Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendim Nr.1886 datë.10.06.1973.*<br>Nisur nga gjendja kritike strukturore e | Përfunduar. Kthim përgjigje me email. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | konakëve të këtij manastiri, në 2021 IKTK hartoi një projekt restaurimi të plot (projekti arkitektonik dhe ai i pikturës murale) për gjithë pjesët përbërëse të manastirit i cili u miratua në KKTKM me Vendim nr.526, datë11.08.2021.<br>Ky projekt për mungesë fondesh nuk është zbatuar ende.<br><br>Objekti pasuri kulturore, Manastirit i Shën Mërisë në Ardenicë është një ndër objektet e renditura në listën e riskut e cila përditësohet çdo fillim viti. Lista e riskut është organizuar në mënyrë të tillë ku janë renditur pasurit kulturore të vlerësuara në risk sipas një matrice vlerësimi të klasifikimit të rrezikshmërisë, ku të gjitha Drejtoritë Rajonale të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Trashëgimisë Kulturore në bashkërendim me IKTK vendosin prioritet e kërkesave për investime në këto objekte në mënyrë që të realizojnë restaurimin e tyre sa më parë të jetë e mundur për të mos i humbur këto pasuri kulturore dhe tejçimin e vlerave të pa diskutueshme që ato mbartin brezave të ardhshëm.<br>Bazuar në listën e riskut, në fillim të viti 2023 është hartuar Fisha e investimit (vetëm për projektin arkitektonik) dhe i është dërguar Ministrisë së Kulturës si një nga objektet e trashëgimisë kulturore të renditura në PBA për investim në vitin 2024. Fondi i kërkuar është bazuar në preventivin e projektit të miratuar në KKTKM, me një shumë prej 5,745,000 lekë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 12.10.2023 | Projekti kulturor “Vila Art Rezidencë Tirana” nga kush do të zbatohet dhe për sa kohë do ti vihen në dispozicion ambientet e ish – vilës së diktatorit?<br><br>Në çfarë konsiston projekti?<br><br>A do të aksesohet ish – vila diktatorit nga publiku gjatë kohës së zbatimit të këtij projekti? | 17.10.2023 | Keshilli i Ministrave me vendimin nr. 570, date 11.10.2023 ka miratuar aktin "Per miratimin e tarifes se reduktuar per dhenien ne shfrytezim te disa ambienteve ne objektin "Rezidence Qeveritare, Vila 31, Tirane, per realizimin e projektit kulturor "Vila Art Rezidence Tirana";<br>Ne zbatim te ketij vendimi, lindin nje sere procedurash administrative te cilat duhet te zbatohen deri ne implementimin e ketij projekti kulturor;<br>Per sa me siper, nevojitet pak me shume kohe per t'ju vene ne dispozicion nje informacion me te detajuar per shkak te procedurave administrative te metejshme qe ky Vendim i Keshillit te Ministrave dikton. | Përfunduar. Kthim përgjigje me email | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 7 | 14.10.2023 | Së pari, do të donim të dinim vlerën konkrete financiare për përfitimet nga secili subjekt, (OJF dhe individë), për vitin 2022 dhe vitin 2023. Sa ka qenë vlera totale e fondit dhe ndarja më pas e fondit për secilin përfitues?<br><br>Së dyti, duam të dimë anëtarët e komisionit vlerësues për miratimin e Thirrjes për Projekte për të dy vitet, si në vitin 2022 dhe në vitin 2023. | 26.12.2023 | Informacioni i kërkuar është vënë në dispozicion. | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë. | Nuk ka. |
| 8 | 26.10.2023 | Infromacion per furrat antike dhe varrezën romake te zbuluara ne Apoloni në vitin 2021 gjate punimeve për rrugen që lidh by Pass-in me Parkun Arkeologjik | 7.11.2023 | Gërmimet arkeologjike në kuadër të projektit të rrugës lidhëse "Bypass Fier–Parku Arkeologjik Apoloni Sektori B", janë realizuar përgjatë vitit 2021 nga subjekti I licencuar në arkeologji "AD STAR" sh.p.k. Zbulimet arkeologjike në këtë zonë u mundësuan, pasi më parë e gjithë hapësira ju nënshtrua sondazheve | Përfunduar. Kthim përgjigje me email. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | arkeologjike, të cilat mundësuan identifikimin e potencialit arkeologjik dhe më pas Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë (aktualisht KKTKM), miratoi konceptin e gërmimit arkeologjik (Vendimet bashkëlidhur).<br>Pas përfundimit të gërmimit arkeologjik dokumetimit të plotë të gjetjeve arkeologjike si dhe bazuar në raportin e rezultateve të gërmimit arkeologjik, KKTKM me Vendim Nr. 663 datë 10.12.2021 u vendos miratimi i raportit përfundimtar të gërmimeve arkeologjike dhe ruajtja në vend e strukturave të zbuluara.<br>Gjurma aktuale e rrugës lidhëse "Bypass Fier – Parku Arkeologjik Apoloni Sektori B", është | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | miratuar me vendim Nr. 18 datë 18.02.2015 të KKA, si variant më me pak ndikim në potencialin arkeologjik të zonës, e cila pjesërisht kalon në gjurmën ekzistuese dhe pjesërisht në gjurmë të re.<br>Qëndrimi i Ministrisë së Kulturës në lidhje me rezultatet e gërmimeve arkeologjike të realizuara në kuadër të rrugës lidhëse “Bypass Fier – Parku Arkeologjik Apoloni Sektori B”, është i shprehur përmes vendimit të KKTKM. | | |
| 9 | 3.11.2023 | Informacion në lidhje me vlerat financiare te projekteve fituese per vitet 2020, 2021, 2022. | 1.12.2023 | 1.Lutem gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese, listën dhe shumën totale të fondit të vënë në dispozicion për projekt-propozimet fituese në kuadër të Thirrjeve për vitet 2020-2023. | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2.Në lidhje me kërkesën tuaj për pajisje me dokumentacionin e vlerësimit të Kolegjiumit për projekt-propozimet, ju bëjmë me dije se në zbatim të rregullores, Kolegjiumi pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur për projektin kulturor, propozon pranë ministrit përgjegjës për kulturën, miratimin e projekteve kulturore të përzgjedhura, duke paraqitur procesverbalin e mbledhjes dhe vendimin e tij. Sqarojmë se ky dokumentacion shoqërohet me një tabelë të detajuar e cila përmban të dhëna personale të aplikantëve fitues si dhe të dhëna të cilat cënojnë të drejtat e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | autorit sa i përket detajeve të projekteve të paraqitura. | | |
| 10. | 7.11.2023 | Informacion lidhur me situaten e monumentit te kultures "Kullat e Dervishaliut" | 10.11.2023 | Pranë arkivit teknik të IKTK-së disponojmë dokumentacion arkivor për objektin pasuri kulturore "Kullat e Dervish Aliu", në fshatin Dukat, Vlorë si më poshtë:<br><br>Skeda teknike (plane, pamje skica etj) vitet 80-të shek XX;<br>Fletë grafike të ndërhyrjeve restauruese për objektin viti 1978;<br>Projekte restaurimi te viteve të fundit me të drejtë autori.<br>Për sa më sipër, lutem të specifikohet nga i interesuari qëllimi i kërkesës, cilin dokument kerkon dhe në cilësinë e kujt e kërkon. | Përfunduar. Kthim përgjigje me email. | Nuk ka. |
| 11 | 8.11.2023 | Informacion në lidhje me vlerat financiare te projekteve fituese per vitet 2020, 2021, 2022. | 22.12.2023 | Informacioni i kerkuar eshte vene ne dispozicion. | Perfunduar. Kthim pergjigje me shkrese. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | 9.11.2023 | Kerkohet relacioni shpjegues per VKM. Nr. 581, datë 11.10.2023 | 20.11.2023 | Vendosur ne dispozicion dokumentacioni | Perfunduar. Kthim pergjigje me email. | Nuk ka. |
| 13 | 7.11.2023 | Informacion mbi nderhyrjet emergjente ne Uren e Matit | 21.11.2023 | Për procedurën me objekt "Ndërhyrje emergjente në objektin Monument Kulture “Ura e Matit”, Ministria e Kulturës ka zhvilluar 3 procedura prokurimi, prej të cilave dy kanë qenë të pa suksesshme për shkak se ofertuesit nuk plotësonin kushtet dhe kriteret dhe në thirrjen e tretë nuk ka ofertuar asnjë Operator Ekonomik.<br>2. Puna për rehabilitimin e Urës së Matit do të fillojë menjëherë pas lidhjes së kontratës me fituesin që do të shpallet në përfundim të fazës prokurimit publik. | Perfunduar. Kthim pergjigje me shkresë. | Nuk ka. |
| 14 | 24.11.2023 | Kërkesë për Informacion mbi punimet për portin e portit të hidrokarbureve | 5.12.2023 | Agjencia e SHerbimit Arkeologjik (aktualisht DSHA), ne cilesine e Sekretarise Teknike te | Perfunduar. Kthim pergjigje me email. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në Porto-Romano, Durrës | | Keshillit Kombetar te Arkeologjise(KKA - Aktualisht KKTKM), ka shqyrtuar dhe miratuar raportin e vezhgimit arkeologjik siperfaqesor ne kuader te projektit "Ndertimi i Portit MBM".<br>Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore nuk ka asnje proces ghyqesor te hapur ne lidhje me zbatimin e ketij proekti.<br>Bashkelidhur gjeni: Vendimin e KKA per miratimin e raportit arkeologjik, planvendosjen dhe prezantimin e projektit zhvillimor. | | |
| 15 | 4.12.2023 | 1.Sa është numri i kontratave të miratuara deri tani dhe sa të tjera janë në procedurë e sipër?<br><br>2. Kërkoj të më vihet në dispozicion një kopje e këtyre | 18.12.2023 | Ligji për trashëgiminë kulturore dhe muzetë është miratuar në vitin 2018, në zbatim të të cilit është miratuar vendimi nr. 857, datë 24.12.2019 i Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të* | Perfunduar. Kthim pergjigje me shkresë. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kontratave të lidhura mes palëve.<br><br>3. Sa është numri i kontratave të dhëna në kohë të ndryshme për veprimtarinë e bareve dhe<br><br>restoranteve mbi kalatë e Shqipërisë prej momentit kur hyri ne fuqi VKM?<br><br>4. Sa është numri i përgjithshëm i kontratave të tilla të dhëna edhe më herët psh 20 vitet e fundit?<br><br>5. A janë respektuar kriteret e përcaktuara në VKM për dhënien e këtyre kontratave?<br><br>6. Cili është përfitimi që sjell për buxhetin e shtetit një kontratë e tillë dhe cila është shumatorja e | | *konkurrimit, formën e kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike".*<br><br>Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se deri më tani Ministria e Kulturës nuk ka miratuar asnjë kontratë/ procedurë në zbatim të bazës ligjore të sipërcituar. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përfitimit për të gjtiha kontratat?<br><br>7. Cilat janë kriteret dhe mekanizmat që garantojnë ruajtjen e objketeve të trashëgimisë kultuore për<br><br>të shmangur dëmin që mund të sjellë aktiviteti i caktuar tregtar. Psh bare apo restorante mbi kala?<br><br>8. Cilat janë kostot që sjellin në mjedis këto aktivitete tregtare, bare e restorante mbi kala? | | | | |
| 16 | 4.12.2023 | Informacion në lidhje me tenderin "Restaurimi, Rikonstruksioni dhe Rehabilitimi I hapësirave në Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura (Galeria e Arteve). | 7.12.2023 | Sa i përket pyetjes suaj se cila ose cilat shoqëri janë fituese të realizimit të këtij projekti, ju bëjme me dije se për realizimin e këtij projekti Ministria e Kulturës ka zhvilluar procedurën prokuruese nga e cila ka dalë fitues dhe është lidhur kontrata me Bashkimin | Perfunduar. Kthim pergjigje me shkresë. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e Operatorëve Ekonomikë.<br>2. Sa i përket pyetjes suaj nëse ka përfunduar ky projekt, ju bëjmë më dije se ky projekt nuk ka përfunduar akoma dhe është në fazë punimesh. | | |
| 17 | 7.12.2023 | Informacion në lidhje me vlerat financiare te projekteve fituese per vitet 2020, 2021, 2022. | 26.12.2023 | Informacioni i kërkuar është vënë në dispozicion. | Perfunduar. Kthim pergjigje me shkresë. | Nuk ka. |
| 18 | 11.12.2023 | Kërkesa lidhet me situatën e Urës së Zogut, monument kulture, që prej vitesh po rrezikohet.<br><br>Ministria e Kulturës ka miratuar një projekt ndërhyrje në këtë monument i cili ka mbetur i pazbatuar.<br><br>1. Përse nuk po zbatohet projekti?<br><br>2. Përse po dështon tenderimi i kompanisë zbatuese? | 19.12.2023 | 1. Përse nuk po zbatohet projekti? Procedura e Konkurrimit Publik është publikuar disa herë në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencise së Prokurimeve Publike, si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës. Gjatë vlerësimit të Operatorëve Ekonomikë pjesmarrës është konstatuar se nuk kanë përmbushur kriteret për kualifikim të paraqitura në | Perfunduar. Kthim pergjigje me email. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3. Sa është buxheti i planifikuar për ndërhyrjen?<br><br>4. A është bërë ndonjë ndërhyrje deri më tani?<br><br>5. Nga inspektimet në terren, a keni konstatuar ulje më shumë urës? Dhe sa ka lëvizur?<br><br>6. Cilët janë faktorët që e rrezikojnë dhe e dëmtojnë më shumë atë?<br><br>7. A është një nga faktorët edhe gërryrja e shtratit të lumit nga kompanitë private që operojnë aty?<br><br>8. A keni një afat se kur do të nisë ndryrja e plotë restauruese dhe përforcuese në Urën e Zogut? | | Dokumentet Standarte te Konkurrimit Publik në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.<br><br>2. Përse po dështon tenderimi i kompanisë zbatuese?<br>Operatoret Ekonomik pjesëmarrës në Konkurrimin Publik janë skualifikuar për arsye se nuk kanë përmbushur kriteret për kualifikim të cilat janë thelbësore për realizimin e këtij projekti.<br><br>3. Sa është buxheti i planifikuar për ndërhyrjen?<br>Fondi/vlera e kontratës sipas projektit dhe përllogaritjes të kryer nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe te miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale eshte 46.663.423 (dyzet e gjashtë milion e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.<br><br>4. Nga inspektimet në terren, a keni konstatuar ulje më shumë urës? Dhe sa ka lëvizur?<br>Instituti Kombëtarë i Trashëgimisë Kulturore si dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër, ka ndjekur nga afër në mënyrë të vazhdueshme situatën lidhur me Urën e Matit, objekt i cili gëzon statusin e pasurisë kulturore shpallur me VKM 313 Dt 08.07.1999 "Për shpalljen monument kulture Ura e Matit" dhe ka konstatuar se zhytja dhe animi i saj janë aktive.<br><br>5. Cilët janë faktorët që e rrezikojnë dhe e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dëmtojnë më shumë atë?<br>Në projektin e miratuar më KKTKM me vendim nr.56, datë 13.02.2023, dhe më konkretisht në relacionin teknik evidentohet se përkeqësimi i gjendjes së Urës mund të vijnë si rezultat i kushteve klimaterike, reshjeve të dendura si dhe të shkarkimeve nga kaskada e Hec-eve mbi Drin. Gërryerjet e vazhdueshme të materialit brenda dhe jashtë palankolës mund të kenë çuar në uljet periodike të këmbës dhe animin e saj duke e bërë akoma edhe më të vështirë situatën.<br>Bashkelidhur do te gjeni edhe vendimin relacionin dhe projektin e miratuar ne KKTKM per pasurine Kulturore Ura e Zogut (Ura e Matit). | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | https://www.transferxl.com/doënload/08jq9nRrGv88nc<br><br>6. A keni një afat se kur do të nisë ndryrja e plotë restauruese dhe përforcuese në Urën e Zogut?<br><br>Publikimi i fundit i procedurës së Konkurrimit Publik në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare pranë APP është dt.81.12.2023 dhe pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave do te shpallet Njoftimi i Fituesit për të vijuar me nënshkrimin e kontratës.<br>Kjo ndërhyrje përforcuese në Urën e Matit është parashikuar sipas Projektit të hartuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), si dhe do të ketë një | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kohëzgjatje 30 ditë nga fillimi i punimeve. | | |
| 19 | 193.12.2023 | Një kopje të të gjithë formularëve të udhëzimit nr.2 datë.30.04.2002 Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të shtetit dhe plotësimin e Formularëve. | 20.12.2023 | Kaluar për kompetencë Agjencisë së Transferimit të Pronave | Deleguar me email. | Nuk ka. |
| 20 | 14.12.2023 | Informacione teknike(arkitekturore) si planimetri të godinës apo materiale të tjera, informacione historike, sic është vazhdimësia e aktiviteteve në godinë që nga fillimet e saj, informacione administrative, pra kapaciteti i vetë godinës, numri i punonjësve që kanë zhvilluar aktivitetin në atë godinë, si dhe numrin apo hapsirat e dedikuara për skena të filmave asokohe. | 22.12.2023 | Korpusi Qendror i Ansamblit që përbën Ish Kinostudion (Albafilm Studio), Tiranë ka statusin "monument kulture" i kategorisë II-të, miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Urdhër Nr.202, datë 24.05.2001. Në arkivin teknik te IKTK-se nuk disponojme skica/ rilevime te vjetra për këtë objekt pasuri kulturore, por vetem projekte te reja të cilat janë me të drejtë autori. Sa me sipër, mbështetur në Ligjin Nr. 119/2014 ''Për të | Perfunduar. Kthim pergjigje me email. | Nuk ka. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Drejtën e Informimit'', përkatësisht neni 17, këto projekte nuk mund t'ju vendosen në dispozicion pasi përmbajnë të dhëna të cilat cënojnë të drejtën e autorit duke mos patur miratimin paraprak me shkrim nga ana e autorëve.<br>Ju informojmë se lidhur me objektin në studim mund të hulumtoni pranë Arkivit Teknik të Ndërtimit (AQTN) | | |